



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Asfaltim rruga stacioni trenit – perimore Mamurras, Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45233140-2 / 44113620-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,083,333 (dymbëdhjetë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 241,666 (dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlloritur të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2.b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures është “Procedurë e hapur”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku percaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b)vlerën e përlloritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku percaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar

se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*" i ndryshuar , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitin 2024 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 " Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "*Per procedurat tatimore*" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 "*Per QKB*" i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "*Per QKR*" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti Teknik (Aftësitë teknike dhe profesionale):

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se **150% e fondit limit të kontratës që prokurohet**.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. **Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim** (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” të ndryshuar).*

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratën/at e sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Faturën/at tatimore

2.3.1/2 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

2.3.1/3 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vleren 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se 150% e vleres limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatoret ekonomike duhet te paraqesin licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NP - 1 A Punime gërmimi në tokë.
- NP -4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

Për punimet speciale të ndërtimit, duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS - 6 A Sinjalistika rrugore jo ndricuese.
- NS - 18 A Punime topogjeodezike.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të

Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur ne SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime gërmimi në tokë	Sips zërave në preventiv kemi punime gërmimi	A	0 - 20 mln leke
NP -4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Sips zërave në preventiv kemi punime rruge	A	0 - 20 mln leke
NS - 6 A	Sinjalistika rrugore jo ndricuese.	Gjate zbatimit punimeve ka punime sinjalistike rrugore	A	0 - 20 mln leke
NS - 18 A	Punime topogjeodezike	Gjate zbatimit punimeve do behen matje topografike	A	0 - 20 mln leke

Jane kerkuar keto pika license, pasi kemi punime mirembajtje dhe riparimi si dhe punime te thjeshta prishje si dhe sinjalistike. Gjithashtu eshte kerkuar Klasifikimi A pasi punimet sipas preventivin perfshihen ne vlerën (0-20 milion leke).

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- b. Inxhinier Gjeodet/topograf/makshajder 1 (një)

Për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për sejcilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqese, Kontratë pune e vlefshme, diplomë , dhe CV, si dhe duhet të jetë në Listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën muajsh e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c) dhe 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punetore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Sqarojme se eshte kerkuar nje Ing. Ndertimi Drejtues teknik per drejtimin, kontrollin e punimeve ne te gjitha objektet. Inxhinier Gjeodet pasi gjate zbatimit punimeve do behen matje topografike etj.

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë:

1 (një) Teknik Ndërtimi

1 (një) Teknik Topograf

Operatori ekonomik per Stafin mbeshtetes duhet te paraqese kontrate pune te vlefshme, Diplome si dhe te jete ne listepagesat e shoqerise per te pakten **muajn e fundit të deklaruar**.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin mbeshtetes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve qe parashikohen te behen. Tekniket nevojitet për drejtimin e punimeve në kantier, organizimin e punes cdo dite, matje etj dhe janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Prania e stafit teknik per afat te caktuar ne listepagesa muaji i fundit i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje punimet ne kohe dhe me cilesi.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjes, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikate te Trajnimit për **“Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne Pune”**, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, i cili duhet te figuroje ne listepagesat e shoqërisë për të paktën muajn e fundit te deklaruar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe ligjin 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” i ndryshuar, ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjësit**, si më poshtë:

A. Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontrate punës të vlefshme, deshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi /IQT të vlefshme si dhe duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise te paktën **muajn e fundit të deklaruar:**

- Specialist ndërtimi/Karpentier/Murator 3
- Hidraulike 1
- Elektracist 1

B. Puntore te thjeshte (te ndryshem) 5 (pesë) per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, si dhe te figurojne në listepagesat e shoqërisë minimumi mujin e fundit.

C. Të ketë në stafin e punonjesve të pajisur me deshmitë e aftësi profesionale per manovratorët, lejet e drejtimit per shoferet, si dhe kontratat e punës të vlefshme:

- Shofer - 2
- Automaknist / Manovrator - 2

Specialitet e mesiperm duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise per te pakten muaj e fundit te deklaruar ose te kontraktuar per këtë procedurë.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c) dhe 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punetore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve dhe mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Specialitet e ndertimit duhen per te kryer punimet e ndryshme ndryshme gjate punes. Hidrauliku është kërkuar pasi mund të nevojitet për eliminimin e difekteve të mundshme të linjave të ujit ekzistuese në rrugë duke qene se është zone e banuar. Elektriciستی nevojitet pasi ka linja elektrike gjate rruges si dhe zone e banuar ne te dyja anet.

Puntoret e thjeshte jane kerkuar pasi sherbejne per punimet ne vazhdim pune krahu deri ne perfundim te punimeve. Shoferet jane kerkuar pasi nevojitet per te drejtuar kamionet ndersa automakinist/manovrator per mjetet e renda.

Specialitet e mesiperm janë te nevojshem per zbatimin e punimeve objekt kontrate bazuar ne ligjin 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” i ndryshuar.

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; Kontrata e punës e vlefshme, Diploma si dhe të figuroje ne listepagesa per te pakten muajn e fundit te deklaruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ne nenin 39, pika 6, germa c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj

teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoresh minimalisht **18 (tetëmbëdhjetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit **për periudhën muajsh e fundit të deklaruar**, e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtoresh është bërë në perputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në një afat kohor prej 60 ditë/2 muaj, i cili kërkon fuqi punëtoresh si dhe bazuar në mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Kapaciteti për fuqi punëtoresh i kërkuar në këtë kërkesë për kualifikim bazohet në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme).

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Afati i realizimit të punimeve është 60 ditë/ 2 muaj.

Sasia e orëve të punës sipas manualit, analizave teknike të punimeve është 8,640 orë punë (punëtor) : 8 orë punë në ditë = 1080 dp: 60dp = **18 punonjës**.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën muajsh e fundit të deklaruar, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoresh të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues mbi 10 ton kap. mbajtes	Në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamioncina vetshkarkues deri 3.5 ton kap. mbajtes	Në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamion me vinc	Në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Ekskavator me goma / zinxhir gome	Në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Rrul jo me pak se 10 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Rrul i vogel deri 6 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Autobitumatrice	Në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Nyje Asfalti	Në pronësi ose me qira/ kontrate furnizimi	Copë 1
13	Motobetoniere	Në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Pompa uji	Në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Motogjenerator/gjenerator	Në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Matrapik (Auto ose dore)	Në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi	Në pronësiose me qira	Copë 10

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit si: - **çertifikaten e pronësise; -leja e qarkullimit; - çertifikaten e kontrollit teknik** (e vlefshme); **siguracionin** (i vlefshëm); **Taksat Vjetore** (te vlefshme), **Çertifikatë transporti** (e vlefshme) si dhe **foto të mjetit** ku të evidentohen qartësisht të dhenat e tij.

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme jane vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qera janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Gjithashtu mjetet e mësipërme janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të kontratës referuar punimeve në preventive si dhe afatit kohor.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001-2018 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë

pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 39, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Shënim: Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kerkese ne rruge elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do te jete kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.
Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta,
konsiderohen kushte për skualifikim.**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.4828 Prot, datë 09.10.2024 (Projekt i cili është bashkëlidhur dosjes).

Jane hedhur se bashku me dokumentat teknike të tenderit ku janë shprehur qartë kërkesat AK për cilësinë e të gjithë punimeve për realizimin e kontratës, në të cilin janë argumentuar edhe punimet e parashikuara në projekt-preventiv.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Benard Palaj Anëtar
3. Rudolf Toma Anëtar